

BESNIK MUSTAJ
VERA PA KTHIM
ROMAN

BOTIMET TOENA

BESNIK MUSTAJ

Vera pa kthim

Roman

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2015

Botuese: Irena Toçi

Korrektore letrare: Majlinda Bami
Përkujdesja grafike: Elida Stafa
Kopertina: Lavdie Cenmurati

© Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me çdo mjet apo formë, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të autorit.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollesha", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116; 22 58 893

Fax: +355 4 22 40 117

E-mail: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

*I vdekuri me të vdekurit,
i gjalli me të gjallët.*

Proverb shqiptar

I

Çasti më i vështirë, kur edhe tavani mbi kokën e Sanës zuri të rrotullohej si një tepsi e çmendur, ishte çasti i parë i takimit. Ai erdhi krejt papritur dhe ishte mëngjes herët, ajo koha e ndërmjetme, kur njeriu ende është disi nën pushtetin e ëndrrave të natës e bile, jo rrallëherë, pa e vënë re ç'po bëjnë, priret t'u shtojë diçka nga magjia ëndrrave figurave reale që e rrethojnë. Sana ishte zgjuar si zakonisht të dielave, e pakënaqur për ditën e zbrazët që do të kishte përpara dhe po bënte atë që i dukej prej vitesh si më e përshtatshme për të harruar veten: pastrimin rrënjësor të shtëpisë. I pati ngritur të gjithë qilimat e mbulesat, i kishte shkundur një e nga një me kujdes në oborr dhe i kishte vënë palë-palë mbi një karrige në korridor, për t'i shtruar kur të mbaronte edhe me heqjen e pluhurave. Kur ra zilja, ajo po bënte gati makinën larëse për të futur në të çarçafët dhe këllëfët e jastëkëve, hedhur grumbull pas derës në dhomën e gjumit. Priti me një fytyrë të rrudhur nga bezdia sa tringëlliu edhe një herë zilja, pastaj hodhi sytë me të njëjtën bezdi rreth e rrotull të gjente një shami çkado

për të mbuluar kokën e pakrehur. Nuk priste njeri. Ia dinin tashmë prej vitesh edhe të afërmit e miqtë se të dielën paradite ajo merrej gjithmonë me pastrime dhe nuk i vinin kurrë në atë kohë. Më vonë, Sana do të çuditej fort me veten si nuk i ngjalli asnjë parandjenjë ajo zile e pazakonshme në derën e saj.

Ndërsa zgjaste dorën si mekanikisht drejt çelësit, me syrin e mendjes pa edhe një herë grumbullin e çarçafëve të palarë, kapakun e hapur të makinës larëse, fshesën me korrent të mbështetur pa kujdes në një qoshe tjetër dhe aty pranë, mbi shpinoren e karriges, palën e madhe të qilimave e të mbulesave. U ndal. Ishte gati të kthehej mbrapsht. Ajo kishte qenë gjithmonë meraklie e pashoqe për gjërat që e rrethonin. Sana vuante po të shihte kush papastërti a çrregullim në veshjen apo në shtëpinë e saj. Dora i kishte mbetur e ngrirë te çelësi i derës, athua se bezdia e mbledhur si llum kafeje në të dy skajet e buzëve, ishte bërë ngërç për t'u përcjellë nëpër të gjithë fijet e nervave deri te bulëzat e gishtave. Asaj nuk i ndodhte kurrë të pyeste kush ishte prapa derës. Në shtëpinë e saj nuk vinin të panjohur. Kësaj here, e përshkuar nga një valë e përndezur acarimi pse po i prishej zakoni, pyeti pa e kuptuar as vetë nga i doli zëri:

- Kush është?

- Sana, ti je?

Kush tjetër veç asaj mund të gjendej e mbyllur në këtë shtëpi? Sana nuk arriti t'ia bënte vetes një pyetje të tillë, ku edhe do të ishte shkarkuar ajo vala e përndezur e acarimit, që i frynte gjithë fishkëllimë nëpër fijet e holluara të flokëve. Dyshemeja nën këmbët e saj zuri sakaq të lëkundej. Për të mos rënë, ajo zgjati instinktivisht të dyja duart drejt murit përballë. Por edhe ai lëvizti. Suvaja e bardhë

u zhubravit e u plasarit gjithandej, duke lëshuar një pluhur gëlqereje që Sanës iu fut në sy dhe ia mjegulloi shikimin. Ajo lëvizi duart verbazi nga të gjitha anët dhe, kur nuk i zunë në asgjë të fortë për t'u mbështetur sadopak, u dorëzua. Le të gremisej përtokë! Një përkujdesje e pakuptimtë i vetëtiu nëpër mend: sido që të vinte puna, nuk duhej të rënkonte. Dhe kafshoi buzën ende pa ndjerë ndonjë uturimë vaji t'i ngjitej nëpër fyt. Pastaj iu duk sikur edhe dyshemeja ishte hapur dhe po fundosej bashkë me trupin e saj të zhbërë. Veçse, për çudi, koka, as këmbët, as brinjët nuk i ndeshnin në asnjë pengesë, thua se tërë qenia e saj e kishte humbur befaz përbërjen prej mishi dhe kocke. Ose ajo vetë bashkë me trarët dhe pllakat prej çimentoje të dyshemesë po përshkonte një hapësirë qiellore. Kështu rënia do të ishte dhe më tmerrshme. Sana hoqi dorë nga përkujdesja për ta mbajtur me patjetër brenda vetes ankimin. Ajo do të kishte dashur të çuditej me sedrën e saj sa shpejt u dorëzua. Kishte besuar gjithmonë se vetmia e kishte kalitur aq sa t'ia ndalonte vetes çdo kërkesë për ndihmë. Nuk donte të tregohej e pafuqishme në asnjë rrethanë. Mëshira e të tjerëve, qofshin këta dhe njerëz shumë të afërt, ishte një pasqyrë, ku nuk donte të shihej. Kësaj here do të kishte klithur në kupë të qiellit, le ta dëgjonte kush ta dëgjonte, sikur klithma e zgjuar më në fund rrëmujshtëm në mushkëritë e saj të mos i mbetej në grykë. E ndihmoi të mblidhte veten vetëdija se në shtëpi ndodhej fare vetëm, si gjithmonë, dhe nuk do ta dëgjonte askush klithmën e saj për t'i ardhur pranë të paktën sa për të parë kush ishte pas derës, që e kishte trembur ashtu. I mbetej ta bënte e vetme atë veprim aq të vështirë. Përndryshe, njeriu pas derës, kushdo që të ishte, do të mendonte keq për të. Ai madje mund të mendonte edhe se ajo ishte çmendur. Vetë do ta bëj, tha e përmendur

plotësisht. Atëherë iu kthye në vesh jehona e butë e zërit të atij që vazhdonte të priste prapa derës. Sana u shtang. Koka iu zbraz siç zbrazet një enë e përmbysur. Ndjeu buzët e veta që mërmërisnin:

- Gori! Gori!

Ndërkohë, po përpiquej me të gjitha forcat ta zgjaste në veshë jehonën e zërit të tjetrit, për të cilin nuk kishte më dyshim: ishte zëri i Gorit. Nuk ngopej së shijuari me të gjitha shqisat. Zëri ishte nga të vetmet gjëra të Gorit, që ajo besonte prej vitesh se nuk rronte më në kujtimet e saj. Sana zbuloi se tingëllima e zërit e ringjallka të munguarin edhe më shumë se fotografitë dhe sendet e tjera të tij, që mund të shiheshin me sy, të prekeshin me dorë. Sana besoi me një ligështim të befasishëm se kjo harresë e zërit të Gorit kishte qenë një ndëshkim krejt i veçantë për të. Ajo nuk kishte fuqi ta kërkonte psenë e këtij ndëshkimi shtesë. Aq më pak kishte fuqi të pyeste kush ishte ndëshkuesi. Por kjo edhe nuk kishte më farë rëndësie në fund të fundit, për sa kohë ajo po e dëgjonte përsëri atë zë. Kishte megjithatë diçka që nuk shkonte. Ajo ia hoqi përdhunshëm të drejtën vetes të gërmonte se çfarë ishte ajo diçkaja që nuk shkonte. Mblodhi gjithë vullnetin për të bërë atë që i takonte: të sigurohej se nuk e kishin gënjyer veshët.

- Gori! Ti je? - Nga të rrahurat e shpeshtuara befas, zemra iu ngjiti deri te fyti. Po i zihej fryma. Sana shtrëngoi fort dorezën e derës, plot me frikë se gjithçka do të fillonte të lëkundej, të thërrmohej e të shuhej sërish në një shtjellë pluhuri të bardhë. Ajo e dinte se nuk do të kishte më për të vend në asgjënë e pluhurt që do të mbetej për të mbushur boshin.

- Hape, Sana! Kush tjetër do të jetë veç meje? Pse më le prapa derës si të huaj?

Zëri i Gorit erdhi i zbutur, si të kalonte nëpër shtratin e mjegulluar të një lumi, ku ajri pranveror i ngopur me lagështirë, ua ka shuar kumbimin të gjitha zhurmave të natyrës. E mbërthyer me të dhjetë gishtërinjtë pas dorezës së derës, Sana përsëri nuk ishte në gjendje të lëvizte. E kishte mbytur një dënesë.

- Hape, Sana, pra, hape! Po qan?

- Qaj nga gëzimi, - arriti ajo të përgjigjej. - Qaj nga gëzimi, - përsëriti prapë pak çaste më vonë, me kokën të mbështetur në kraharorin e tij. - Nuk më besohet që erdhe. Kjo është mrekullia.

- Pse s'të besohet? Do të vija patjetër, si jo? - Ai mori pamjen e burrit të prekur në sedër nga dyshimi i Sanës. - Ta kam shkelur ndonjëherë fjalën?

- Jo, jo, kurrë. Po ja, shkoj kaq kohë...

- Ç't'i bësh, ashtu u soll puna, ti e merr me mend, - tha Gori dhe zëri i tij erdhi duke u shuar, si ta përpinte po ai vetë, me sytë që iu fshehën vështrimit ngulmues të Sanës. Ai e ndjeu që Sana po bëhej gati ta pyeste për diçka. Ajo do ta pyeste pikërisht se çfarë punësh ishin ato, që e kishin mbërthyer kaq vite larg saj e që ajo duhej t'i merrte me mend. Por edhe thjesht mund ta kundërshtonte, t'i thoshte se ajo nuk merrte me mend asgjë. Sepse vërtet Sana nuk merrte me mend asgjë rreth kushteve që e kishin mbajtur Gorin kaq gjatë larg saj. Për të mos i lënë kohë të pyeste, për t'i mos i lënë kohë madje as të mendonte, Gori ia mori fytyrën midis pëllëmbëve me një gjest përkëdhelës, ia ngriti ngadalë drejt vetes dhe e puthi në buzë. E puthi gjatë, pa ndërprerje. Por ishte një puthje aq e lehtë, sa Sana, çuditërisht, sado që shtrëngohej pas gojës dhe krejt trupit të tij, nuk arrinte e nuk arrinte t'ia ndjente sado pak as prekjen e buzëve e jo më afshin e tyre të valë. Vetëm se

poshtë barkut, midis shalëve, nisi të nxehej siç nuk i kishte ndodhur kushedi qysh kur dhe u mrekullua me veten pse nuk po i vinte fare turp. Kaq i mjaftoi për të qenë e sigurtë që Gori po e puthte dhe gjuha e tij duhej të ishte diku thellë brenda gojës së saj. Ajo i thirri arsyes për ta qortuar veten pse po vonohej në dyshime të kota në vend që t'i gëzohej plotësisht çastit. Nën kapakët e mbyllur të qepallave u zgjua një gaz marramendës.

- Bëre mirë që erdhe, - tha Sana kur nuk putheshin më. Dhe e kërkoi rishitas vështrimin e tij të thellë, që vazhdonte t'i ikte në mënyrë të pashpjegueshme, duke lënë pas një retinë të zbrazët e të çngjyrosur si guaskë e vjetruar. Ky krahasim, që iu shpif papritur, e rrëqethi. Për të mos iu përsëritur më vegime të tilla, ajo e largoi vështrimin prej syve të tij. E ktheu fjalën te vetja. - Më kishte marrë shumë malli. Aq shumë... Sikur ta dija...

- Edhe mua, - e ndërpreu ai. - Malli më kishte përvëlur. Po dhe vuaja pse të kisha lënë të vetme të përballeshe me jetën. Krejt vetëm. Vuaja se ti nuk po jetoje. Do të vija, pra, se s'bën. Pastaj, unë e di mirë sa shumë të mërzitë ty vetmia. Je një vajzë që dije të gëzoheshe aq bukur, por jo në vetmi...

- Di prapë, - u hodh Sana, e përkëdhelur në sedër. Gori e kishte quajtur "vajzë". Por e zuri sakaq frika se mos ai i kërkonte të përsëriste ndonjë nga ato lodrat e saj të dikurshme, sajime foshnjarake, që atij i pëlqenin aq shumë. Ajo nuk do të mund t'i bënte dot më. Madje nuk mbante as mend ku e gjente asokohe përfytyrimin për t'u llastuar. - Kaq kohë! - tha si për t'u shfajësuar para vetes dhe mbajti frymën për të mbytur një psherëtimë që iu ngjit si zhapi nga fundi i kraharorit.

Gori nuk dukej i etur për gjëra të tilla. Ai vetëm përfitonte ta përfshinte me një vështrim të mbushur me mall e fajësi, kur ajo nuk i kishte sytë mbi të. Në të vërtetë, me një shqisë të fshehtë, që po e zbulonte e befasuar te vetja, Sana arriti ta ndiqte mrekullisht vështrimin e ngarkuar të Gorit si zbriste nga fytyra e saj nëpër vijën e mjekrës, në qafë dhe rrëshqiste poshtë nën veshje, ndalej një çast mbi supet e ngrehura, sa për t'i përcikur si paralajmërim për gjinjtë e fryrë nga padurimi, ku do të mbështillej sakaq e do të shtrëngohej më ngeshëm, por jo mjaftueshëm. Vështrimi i Gorit kishte ca gjymtyrë të padukshme, me të cilat tërhiqte pak thithkat e gjinjve dhe i shtypte pastaj lehtë siç shtypet qershia e pjekur mirë për t'i nxjerrë bërthamën. Sana e kishte në majë të gjuhës një përgjërim që ai ta vazhdonte atë shtypje në gjithë rumbullakësinë e gjinjve. Ishte një magji, që asaj nuk i lejohej ta prishte me fjalë apo qoftë edhe duke çelur sytë. Ajo ishte fatlume me shqisë e vet të fshehtë, e cila ia përcillte të gjitha gjurmët e prushit që linte vështrimi i ngarkuar i Gorit duke zbritur ngadalë krejt si një akrep me kthetrat ngulur pas lëkurës së saj nëpër ije e deri te leqet e këmbëve. Ajo ishte e tëra brenda kapërthimit të akrepit. Sana ndiente gjakun t'i rridhte nëpër vrugat e lëna nga çapojt e akrepit dhe i vinte mirë, krejt sikur nxirrte nga vetja një ankth. Dhe sa ngrohtë ndjehej aty!

*

U desh një copë herë e pamatshme që Sanës t'i kalonte disi hutimi i fillimit. Pa shtëpinë e rrëmujshme dhe u kujtua për pamjen e vet. Kushedi si dukem kështu, e pakrehur, veshur me këtë rrobëdëshambrë të përdorur prej vitesh!

mendoj dhe për herë të parë i erdhi inat me maninë e vet për ta pastruar me domosdo fund e krye shtëpinë çdo të diel. Ajo jetonte pa njeri dhe në apartamentin e saj shkelnin aq pak të tjerë, sa fare rrallë mund të ishte nevoja për t'i shkundur shtrojat nga rrënjët. Me siguri që këtë zakon e kishte marrë pikërisht nga jeta vetëm. Te dielën vetmia rëndonte edhe më shumë sepse ishte më e gjatë. Tepër e gjatë. Atë ditë shtëpia zbrazej me tepri. Sana nuk mund të duronte gjithë atë hapësirë ajri të patrazuar nga fryma e askujt tjetër. Edhe pse e dinte tashmë që dita do t'i zgjatej tej mase e do t'i bëhej shpeshherë rraskapitëse, prapë nuk ndalej dot pa u ngritur shumë herët. Vishte rrobëdëshambrin e përdorur, vinte përparësen dhe e kthente gjithçka përmbys me një lloj zemërimi të pafuqishëm. I ngjante se rrëmuja bashkë me uturimën si traktor të makinës së vjetër larëse i gjallëronin dhomat. Por trupit të vet i nxirrte kështu një punë fort të lodhshme e të pakëndshme. Dreka e sidomos darka e gjente tërësisht të këputur. Por Sana këtë donte: t'i vinte shpejt gjumi, pa i lënë kohë të hallakatej nëpër mendime pa zgjidhje. Me kalimin e viteve, ajo hile me veten për ta kapërcyer të dielën iu kthye në zakon dhe iu nguros në mënyrën e jetesës, aq sa nuk mund ta prishte më asgjë. Vetëm i fejuari i saj s'e kishte ditur. Ai zgjodhi pikërisht të dielën jo për ta zënë në befasi. Ashtu qëlloi në kalendarin e tij, ku nuk mund të ndryshonte më asgjë. Gjithsesi, Gori ishte i vetmi njeri në botë me të drejtën e plotë për t'i prishur zakonte e ngurta të Sanës.

Kraharori i këmishës së kaltër të Gorit ishte njomur në tri-katër vende nga lotët e saj, që kishin rrjedhur heshturazi, pa i vënë re as ajo vetë. Sana e njihnte mirë këtë këmishë. E megjithatë diçka nuk shkonte. Ishte e

pabesueshme si ishte ruajtur kjo këmishë gjithë atë kohë. Jo vetëm nuk ishte brejtur gjëkund, nga mola e as nga përdorimi, por as ngjyra nuk i kishte ikur fare. E ka mbajtur mënjanë posaçërisht për ditën e kthimit, ngaqë unë ia pëlqeja gjithmonë, u dha Sana një fund të pëlqyeshëm pikëçuditjeve të veta.

- Ç'do të bëjmë tani? E humbëm fare, - ndërhyri Gori, duke e shkëputur nga ëndërimi.

- Tani ti do të dalësh pa bërë llafe në ballkon, si çun i dëgjueshëm që je, unë do të rregulloj shpejt e shpejt vendin, si gocë punëtore që jam. Pastaj... pastaj bëjmë ç'të duash. Mirë?

- Mirë, veç mos na vono, të lutem! Nuk kemi kohë për të humbur. - Fytyra gjatoshë e Gorit i përcolli këto fjalë me një lëkundje çapkëne.

Oh, sa mirë e dinte Sana që nuk kishin asnjë grimë kohë për të humbur! Duarte e saj, të shkathtësuara si kurrë ndonjëherë, shtrinë qilimat, nxorën për tavolinën një mbulesë të qëndisur nga ajo vetë në një jetë tjetër, atëherë kur ajo përgatitej për dasmën dhe të pashtruar kurrë, vendosën vazot e shumta të luleve në qoshtet e tyre, morën togun e çarçafëve dhe i futën në makinën e larjes siç qenë, pa i ndarë të bardhët nga ata me ngjyrë. Donte vetëm t'i hiqte sysh.

Para se të shkonte për të bërë tualetin e vet, Sana i thirri Gorit që nga korridori me një zë të hareshëm për ta lajmëruar se në dhomë gjithçka ishte gati e ai mund të kthehej brenda. Gori nuk iu përgjigj. As ajo nuk thirri për së dyti. Nuk i bëri ndonjë përshtypje heshtja e tij. Ajo kishte hapur ndërkohë kutinë e tualetit dhe po shihte me një pikëllim të panjohur se e kishte shumë të varfër. Uf, edhe unë! S'duhej ta kisha lënë kaq pas dore! Për vite e vite ajo

kuti tualeti, të cilën Sana nuk e përdorte më, ishte nga gjërat që e trishtonte më tepër sa herë i dilte para syve. Në çaste të tilla nuk përmbahej dot pa shkuar te pasqyra dhe ngulej gjatë para saj. Fillonte të merrej me vetullat, me sytë, me buzët, me mollëzat e faqeve. Pastaj krihte flokët duke i fryrë e përdredhur, gjersa shndërrohej në një nuse të vërtetë. Jo rrallë kjo punë i hante një pasdite të tërë dhe, po të mos mbyllej me të qarat e shfrenuara që vinin gjithmonë tamam atëherë kur nuk i mbetej më asgjë për t'i shtuar portretit të vet të ri, do të ishte një kohë e bukur, e cila e fuste ëmbëlsisht në botën e ëndrrës së vet më të fshehtë e më të shenjtë: të nusëronte. Por, duke mos e duruar dot vuajtjen që i vinte në fund (sidomos më vonë, kur edhe fytyra nisi t'i bindej gjithnjë e më me vështirësi dëshirës për ta marrë pamjen e shndritshme të nuses), Sana e fshehu një ditë prej ditësh kutinë në një skutë, ku të mos e shihte më. Të paktën të mos ia zinte dora rastësisht tek kërkonte diçka tjetër. Rikujtimi i rastësishëm e bën brengën edhe më të rëndë. Uf! i shfryu ajo përsëri vetes. Edhe ti, sa e keqe që je bërë! Sikur ta kishin fajin këto sende! Për të shmangur pyetjen se kush ia kishte fajin dhe sidomos: për çfarë faji ishte fjala, ajo zuri t'i përdorte nxitimthi gjërat që i ndodheshin në kuti. Gati lëshoi një klithmë gëzimi kur pa që kutia e kryente më së miri detyrën e vet. Nuk ishte tharë asgjë. Iu kujtua përsëri këmisha e kaltër e Gorit, që nuk ishte vjetruar fare dhe i pëlqeu të besonte në një mreku të përbashkët.

Dikur iu duk se po vonohej me tepri. Gishtërinjtë e saj e kishin humbur zhdërvjelltësinë që duhej të kishin duart e një gruaje që merret me zbukurimin e fytyrës së vet. U hodhi një vështrim të zemëruar duarve, gati-gati armiqësor, si të mos ishin gjymtyrët e saj. Duar gjysheje,

iu skërmit gishtërinjve të vet të plogësht dhe menjëherë solli sytë përreth e trembur. I ngjau se kishte folur me zë të lartë. Sidomos tani nuk i lejohej më të shprehte mendime të tilla. Gori duhej të zbulonte vetëm freskinë dhe bukurinë e saj të paprekur. Nëpër kokë i shkoi për herë të parë frika nga plakja fizike, e cila, siç thuhej, e zvetënonte me shpejtësi edhe dashurinë. Ose, së paku, ia ftohte asaj pasionin, e shndërronte në diçka tjetër që ishte dhe s'ishte dashuri: sepse e përziente me dhembshurinë. Sana vetëm dhembshurinë e Gorit ndaj saj nuk do të mund ta duronte. Boll u ishte dhembshur kaq kohë të njohurve e të panjohurve të mbarë botës. Dhe vetëm për shkak të Gorit. Në fund të fundit Gori nuk ishte kthyer që ta qetësonte me dhembshuri, po me dashuri.

Nëpër derën e hapur të dhomës së gjumit zgjatej që nga ballkoni hija e burrit. Ia nguli vështrimin një çast asaj hijeje të mezi dallueshme mbi qilim. Ishte një hije e ngrirë, e zbehtë si njollë e moçme boje. Ai s'kishte hyrë brenda, edhe pse Sana e kishte lajmëruar pak më parë se mbaroi me rregullimet. Dhoma, e banuar vetëm nga hija e ngrirë si njollë e moçme boje e Gorit, ngjante tepër e shurdhër. Ajo nuk e shihte ç'bënte ai atje në ballkon, por iu duk e çuditshme si rrinte ashtu i ngulur në një pikë. Kushedi ç'pamje magjepsëse i ishte shfaqur në oborr! Sana tha se në oborrin e saj nuk ishte shfaqur kurrë ndonjë pamje magjepsëse. Megjithatë... mbase... sot... si ditë mrekullish që ishte... Rëndësi kishte që ai nuk e kishte dëgjuar, edhe sikur ajo të kishte sharë me zë duart e veta... Dhe u soll e lehtësuar nga pasqyra të mbaronte sa më shpejt me tualetin. Ngathtësia e gishtërinjve të vet e shtyu të mendonte ankueshëm se edhe detyrimi për tualetin ishte një padrejtësi që u bëhej grave. Tualeti u shërbente atyre

që të zbukuroheshin për sytë e burrave. Vetëm për sytë e burrave. Nuk ishte në gjendje të thoshte nëse ishte një detyrim që ua kishin vënë burrat, apo ia kishin vënë gratë vetes. Sidoqoftë, gratë zbukuroheshin për të qenë të pëlqyeshme nga burrat. Pra, dashje pa dashje, ishin burrat ata që i detyronin. Po burrat përse nuk ndjenin kurrë nevojë të pudroseshin apo të lyenin sytë? Pse duhej që gratë t'i pranonin ata dosido? Aq më tepër që fytyrat e tyre nuk e kishin as butësinë e vetvetishme të fytyrës së grave. Fytyrat e tyre me lëkurë të ashpër e gjysmë të mbuluar me qime ngjanin gjithsesi me... Sana nuk e mbaroi mendimin nga frika se po fyente figurën e Gorit, e cila kishte zënë vend aq thellë brenda saj, atje ku nuk mbërrinte dot hija e ngrirë si njollë e moçme boje mbi qilim, e cila vazhdonte ta shurdhonte dhomën e ndenjjes.

- Po të pres! - i thirri ajo Gorit pas pak tek i hidhte vetes edhe një vështrim të fundit para pasqyrës së korridorit. Zëri i doli i dobët, sepse në fyt ndiente një shtrëngim që i jepte një si ethe nëpër gjithë trupin. I pëlqeu vetja, por kjo e bëri edhe më të ndrojtur. Prova e vërtetë do të ishin sytë e Gorit.

Ajo u mek fare kur dëgjoi hapat e tij të lehtë mbi qilim. Nuk guxoi të kthehej anej. Po sikur ai t'i thoshte: Ç'më je bojatisur kështu, si ato gratë që rrinë nëpër hollet e hoteleve të turistëve? Asaj i erdhi turp për përqasjen që i kaloi nëpër kokë, sado që ishte e bindur se nuk ishte një përshtypje vërtet e lidhur me ngjashmërinë e saj të re. Ishte thjesht një përpjekje e vogël për hakmarrje nga pamja e shkujdesur vajzërore, të cilën ajo sapo kishte braktisur njëherë e përgjithmonë. Dhe, më në fund, e braktisa përgjithmonë, ngulmoi ajo si t'i përgjigjej asaj hakmarrjeje. Unë tashmë jam grua dhe duhet të mendoj me përkushtimin që i takon gruas së një burri.

Gori ishte afruar ngadalë dhe po qëndronte pas shpinës së saj. Sana ndjente frymën e gojës së tij të lëpihej pas zverkut të saj. Ajo nuk mbante më mend nëse i kishte ngritur më lart se zakonisht flokët për ta lënë zbuluar mirë zverkun. Sana i tha vetes se duhej të mësonte shpejt të parashikonte nga këto hollësi në dukje të vogla, por që janë aq të rëndësishme për t'i vënë zjarrin gjakut të burrit siç edhe gjakut të saj prej femre të dëshiruar. Gori e zuri me të dy pëllëmbët për supesh. Kur e ktheu nga vetja, ai sikur u step vërtet pak me dukjen e saj të re: fytyra e qëruar mirë nga gjurmët e gjumit të natës dhe të lotëve të pakmëparshëm, flokët e krehur me kujdes, mbledhur topuz mbi kokë si për ta zgjatur qafën, qerpikët të theksuar me një rimel të lehtë që e ndillnin dritën e mëngjesit të mblidhej në dy pika vezulluese, prej nga shpërndahej sërish valë-valë, fustani i gjelbër që shtrëngohej fort te gjoksi e deri në bel dhe hapej pastaj përnjëherësh duke i dhënë trupit të saj dukjen e një lulekëmbore. Asaj i pëlqeu tej mase ky përskrim e posaçërisht krahasimi me lulekëmborën, sado që nuk do të kishte qenë në gjendje të thoshte me siguri nëse gjithë këto fjalë të magjishme i kishte dëgjuar nga goja e Gorit apo i kishte sajuar truri i saj i nxehur nga hareja.

*

Sana e përjetoi sipas dëshirës së vet stepjen e Gorit dhe u përkëdhel në sedër. Iu davaritën sakaq të gjitha hamendjet e mbrapshta dhe u çel. Por, kur pa se kjo stepje po zgjaste dhe po e mbante Gorin disi larg saj, ajo nuk e deshi më. Për t'ia kthyer burrit rishtas shpengimin në të sjellur, ajo iu afrua vetë e para. U ngrit në majë të

gishtërinjve me një gjest prej çupëline dhe e puthi lehtë në buzë. Ai sikur u shkund nga një ëndërr dhe përpëliti qepallat. Pastaj vuri buzën në gaz. Megjithatë, duart vazhduan t'i qëndronin të varura poshtë, si t'i mbanin lidhur me trupin vetëm mëngët e këmishës. Sanës i kaloi nëpër eshtra diçka e ftohtë, por u përpoq të mos e jepte veten. Mendoi se njeriu hutohet edhe nga malli i madh. Gjërat e pritura gjatë dhe ethshëm i duken të pabesueshme kur ndodhin. Duhet folur diçka, mendoi ajo, një shaka... E qeshura të përmend më mirë se gjithçka në raste të tilla.

- Po të lë pak të kuq, - i tha. - Kur të kalojmë rrugës, t'i bëjmë edhe më shumë njerëzit të kthejnë kokën nga ne.

- Si edhe më shumë? Domethënë edhe pa të kuqin tënd te buzët e mia, njerëzit gjithsesi do ta kthenin kokën nga ne? - u hodh Gori.

- Sigurisht që do ta kthenin, - iu përgjigj Sana, në trurin e së cilës ndërhyrja e tij u përpunua ndryshe.

Ajo u përpoq të vinte buzën në gaz, por e ndjeu se i doli më tepër një ngërdheshje. Mbështeti kokën në gjoksin e tij si për të fshehur fytyrën. Kam harruar edhe të buzëqesh, tha me vete përvajshëm. Nuk donte kurrsesi që Gori të vinte re ndryshime të tilla tek ajo.

Nëpër dritaret e çelura kanatash, paraditja e fundit e majit derdhte brenda afshin e nxehtë të dheut të etur nga mungesa e gjatë e shirave. Kishte qenë një pranverë e thatë. Sanës iu duk se po i përcëllonin mollëzat e faqeve dhe e shtrëngonin ëmbëlsisht sutjenat, si ditën kur i kishte vënë për herë të parë.

- Oh, shpirti im! Unë pyes kot. Sigurisht që edhe pa të kuqin tënd te buzët, mua do të më shohin të gjithë me çudi, - shtoi Gori, tani i qetësuar.

Sana u gjallërua përnjëherësh.

- Pse thua kështu? Për këto bula lagështie në këmishë? Këto t'i heq Sana jote, tani. Ja, një hekur t'u kaloj! Mos u bëj merak fare! - Ajo nisi t'ia zbërthente kopsat e këmishës pa pritur përgjigjen e tij.

- Jo, jo, - ndërhyri Gori dhe ia largoi butë, por prerë, duart nga kraharori, - As që e kisha mendjen aty. Është ajo gjëja tjetër. Ah, sikur të ishte fjala për dy bula lagështie mbi këmishë! Po është diçkaja tjetër. Krejt tjetër, shpirti im. Krejt tjetër, ti e di. - Në zërin e tij kishte një brengë të largët, të pashërueshme e që mbillte pafuqi te dëgjuesi.

Duart e Sanës u mpinë.

- Tani e gjete ti të më thuash budallallëqe të tilla? - iu hodh Sana duke ia kërkuar përsëri sytë edhe më me ngulm. Ajo shpresonte që të paktën sytë e tij ta ndihmonin për të kuptuar diçka më tepër. (Sana nuk e dinte ç'ishte ajo gjëja tjetër, e cila duhej të ngjallte me patjetër çudinë e njerëzve lidhur me Gorin.) Por u pendua shpejt dhe e largoi gjithë panik vështrimin. Nën ballin e Gorit u shfaqën rishtas dy hijet e guaskave të zbrazëta, të cilat e kishin rrëqethur pak më parë.

- Hiç, hiç, bëj shaka, - ndryshoi toni i Gorit. Po mpirja e beftë, që iu ngjiti në fytyrë, nuk i shpëtoi dot vëzhgimit të Sanës, sado që ai nxitoi t'i thoshte më një shkujdesje të shtirur se këmisha nuk kishte nevojë për hekur, do të thahej vetë. Ai ktheu fytyrën nga dritarja.

- Është gjithë ky diell! Pastaj loti nuk lë gjurmë, aq më fort loti i gëzimit. Ti e di më mirë se unë, apo jo?

Sana kishte marrë tashmë diçka nga mpirja e tij ashtu siç merret një energji e keqe. Ajo e dinte, sigurisht, që gjurma e lotit thahet sakaq dhe nuk le gjurmë. Por nuk arriti dot të miratonte as kaq gjë. Ndërhyri Gori për ta shkundur.

- Tani ulu na bëj një drekë të mirë. Pasdite do të nisemi për në plazh, - shtoi ai me një zë të ngutur, si të donte që, me lajmin e papritur, ta largonte sa më shpejt vëmendjen e vajzës nga fjalët e pashpjegueshme që sapo kishte thënë. Ishte radha e tij të përpiqej për të fshehur një panik.

- Për në plazh? Sot? S'kemi si nisemi sot. - Ajo nuk e njohu veten. Sa kohë kishte pa i folur ndonjë burri ashtu, me kundërshtim femëror që në të vërtetë nuk është kundërshtim, por joshje për ta bërë atë më këmbëngulës në dëshirën e tij, dëshirë që femrës i ka pëlqyer thellësisht. Kjo këmbëngulje e mashkullit i është e nevojshme femrës për ta përjetuar deri në fundin e fundit të shpirtit drithërimën e zgjuar prej atij lajmi të paparashikuar. Nga ana tjetër, përtëritja e beftë e asaj sjelljeje femërore, të humbur prej kaq kohësh, Sanës i shkaktoi një si ngërç gjithandej nëpër muskuj. Ajo pati frikë për trupin e vet, që do të duhej të zhvishej po të shkonin në plazh. Iu mbushën sytë me lot. Ashtu e përлотur ia doli të sajonte një arsye jashtë vetes: - Të paktën ta dija që t'u thosha në punë! Merrja lejen e zakonshme. Pse të mos e lëmë për nesër? E lëmë më mirë për nesër, do të më bëjnë llafe...

- Ç'është kjo leja e zakonshme?! - pyeti ai. Dhe pyeti aq seriozisht, sa Sana u detyrua të shpjegonte:

- Leja e zakonshme, pra. Leja vjetore, që garantohet me kodin e punës.

- Ç'do të thotë kjo lejë? Mos shko në punë, nuk do ta paguajnë rrogën dhe pikë. Ç'ka këtu për llafe? - vazhdoi Gori, gjithnjë seriozisht dhe i habitur.

- U, si flet edhe ti, Gori! Sikur s'ke idenë ç'është puna! S'është halli te rroga... Pse, ty atje, në punën tënde, të lë njeri të hysh e të dalësh kur të duash?

- E, e, e di, ke të drejtë, - ia ktheu ai duke i lëshuar fjalët gjysma-gjysma, si të kishte mungesë ajri për të shqiptuar plotësisht tingujt. - Po si t'ia bëjmë atëherë?

- E lëmë për nesër, pra.

- Jo, jo, për nesër s'e lëmë dot. Do të nisemi sot. - Sana e vuri re mirë që ai ishte i vendosur.

- Nuk e marr vesh pse ngul këmbë kështu? Pse sot me patjetër?

- Nuk dua të humbas edhe një ditë të vetme. Dy javët që kemi, t'i kalojmë në plazh. Të kam pasë dhënë fjalën, të kujtohet?

- Më kujtohet, si s'më kujtohet. Po ti flet si t'i kishim ditët të numëruara... Nuk të lë më të ikësh, ngule mirë në mend! Nuk ka më ndarje.

Ai bëri një shenjë me dorë si për të thënë: Ku të shkon mendja dhe ty! Dhe vazhdoi:

- Mos ma prish! Të kam shpirt. Në plazh do të shkojmë sot.

- Mirë, mirë, - u tërhoq Sana, e përkëdhelur në sedër nga lutja e tij. I ishte fshirë me shpejtësi nga kujtesa gjithë çoroditja që i shkaktuan pyetjet e tij të pakuptimta rreth lejes së zakonshme, ashtu siç iu fshi edhe ajo dhembja therëse e ngërçit nëpër muskuj bashkë me frikën se, me rrobat e banjës, trupi i saj nuk do t'i bindej për t'u çliruar nga moria e madhe e pengesave, me të cilat ishte mësuar gjatë jetës për vite e vite në vetmi. Tani kishte në shpirt vetëm shijen e këndshme të arritjes së qëllimit të fillimit: Gori jo vetëm nguli këmbë në dëshirën e vet, por edhe iu lut. Sana u ndje e detyruar t'ia shpërblente këtë kënaqësi, duke ia përforcuar miratimin e vet: - Mbase e rregullojmë me një telefon drejtorit. Nuk besoj të na thotë jo. Ose më mirë i vemi në shtëpi. E ka këtu afër. S'ka gjë se është e diel. Ai nuk do të bezdiset.

- Si të duash, por shpejt, - pranoi Gori. Në zërin e tij u përçoll menjëherë lehtësimi nga tendosja e pakmëparshme, kur ajo, pa asnjë prapamendim i përmendi ditët e numëruara.

Për lejen nuk u vonuan. Derën ua hapi vetë drejtori, një burrë i shkurtër, trupngjeshur e qafëshkurtër si ata që merren me sporte të rënda, rreth të dyzetave, të cilit sa kishin nisur t'i thinjeshin flokët në tëmtha. Ai qëlloi vetëm në shtëpi. Syrit të Sanës nuk i shpëtoi ngurrimi i tjetrit kur i pa të dy bashkë. Nëpër fytyrën e tij të gjerë kaloi një i zbehtë, që ia bëri njolla-njolla lëkurën kuqoshe të faqeve. Dora e tij vetvetiu u shty sakaq të mbyllte derën. Po drejtori e mblodhi po aq shpejt veten dhe, duke parë me një ankth që nuk i shkonte vetëm nga Sana, i ftoi brenda pa u kërkuar ndonjë shpjegim për arsyen e vizitës së pazakonshme. E folura sikur e lehtësoi disi. Megjithatë, dukej që diçka e fortë e mbante për të mos shikuar asnjëherë drejt nga Gori. Veçse e vidhte pareshtur me bisht të syrit. Drejtori e përsëriti me gjysmë zëri ftesën të hynin të paktën sa për një kafe, të cilën do t'ua bënte ai vetë, me kënaqësi. Gruaja kishte dalë për një shëtitje me fëmijët. Por ata kundërshtuan me një zë.

- Nuk kemi kohë. Faleminderit shumë. Nxitojmë. Faleminderit, një herë tjetër me shumë dëshirë...

Gori shqiptonte të njëjtat fjalë dhe njëherësh me Sanën, si të recitonin njëzëri një tekst, për të cilin kishin bërë shumë prova së bashku, gjë që e mahniti Sanën.

- Si jo? - u hodh drejtori sapo dëgjoji përse ishte puna. - Ne, more shoku Gori, mezi të kemi pritur. Dhe ta dish se të kemi mbajtur gjithnjë në gojë. Sepse të kemi pasur orë e çast në zemër. - Kësaj here fytyra e gjerë e drejtorit, në

të cilën kishin filluar të zhdukeshin njollat kuqoshe, guxoi të kthehej plotësisht nga Gori. Megjithatë, si për të mos e këputur lidhjen me Sanën, ai vuri dorën e majtë në supin e saj me një gjest atëror, që i shkonte pavarësisht nga mosha dhe shtoi: - Jo dy javë, rrini një muaj, po deshët! Edhe më shumë. Pa merak. Të çmalleni mirë, si jo? Nga unë ke urdhër ta mbash me kujdes Gorin! - iu kthye prapë Sanës. - Më duket pak i dobësuar. Kushedi sa ka hequr andej! - Ai bëri me dorë një shenjë të papërcaktuar, si të tregonte një vend të paarritshëm, diku prapa diellit që digjte.

- M'u duk burrë i mirë, - tha Gori kur po largoheshin.

- Shumë i mirë është, shumë i mirë, - u përgjigj Sana përhumbshëm. Ende i vërtiteshin në kokë si vrunduj ere fjalët e drejtorit: Kushedi sa ka hequr andej?! Ku andej, ku? Dhe çfarë ka hequr? kishte dashur ajo të pyeste e tronditur. Por kishte kafshuar gjuhën për të mos e zgjatur më tej bisedën. Vetëm kishte ndjekur me sy gjithë ankth lëvizjen e dorës së tij, mbetur një copë herë pezull në ajër, pa u shquar në bënte shenjë nga lartësia e pafundme e qiellit apo nga thellësia e pafundme e tokës, larg, ku humbiste vështrimi, apo afër, nën këmbët e tyre. Ku është kjo "andej", se po plas, pyeti prapë veten më kot ajo gjatë rrugës. Një parandjenjë e fortë e udhëzonte se, sidomos Gorit, nuk duhej t'ia bënte një pyetje të tillë.

Po afronte mesdita dhe vapa e madhe i kishte rralluar lëvizjet e njerëzve nëpër rrugë. Megjithatë, Sana shihte me çudi dhe njëfarë pakënaqësie të papërcaktuar majtas e djathtas. Si nuk po ndeshnin asnjë të njohur? Ku qenkan mbyllur kështu sot të gjithë të njohurit e saj? Do të donte të takonte ndonjë nga ata që, edhe pse me dashamirësi të

ciltër, sa herë i vinin në shtëpi, e bezdisnin dhe ia shtonin vuajtjet duke i qarë hallin për jetën e saj të vetmuar. Pastaj, po me atë dashamirësi, e këshillonin të martohej, të fillonte një jetë tjetër. E shkuara duhej lënë prapa krahëve sipas tyre. Nuk jetohej në të shkuarën. Dhe i kujtonin atë proverbin se i gjalli e ka vendin me të gjallët. T'i takonte ata tani, që ta shihnin me sytë e tyre sa pa vend kishin qenë këshillat e tyre. Asfalti, i shkrirë vende-vende nga vapa, lëshonte një duhmë të rëndë.

- Nxitojmë! - tha Gori. - Era e ziftit më ngacmon të vjellat e më jep dhimbje të tmerrshme koke që nga koha e... - Ai e la në mes fjalën si t'i zihej papritur fyti. I hodhi Sanës një vështrim të pjerrët dhe priti me zemër të ngrirë që ajo ta pyeste se qysh nga cila kohë era e ziftit i jepte dhimbje të tmerrshme koke. Kur u sigurua që ajo nuk e kishte mendjen aty, u qetësua.

- Po ti, Gori...

Sana ndjeu një turbullirë t'i ngjitej në kokë dhe iu pre fjala. U gëlltit fort për të mbytur një valë të nxehtë lotësh në sy dhe, nëpër mjegullën e tyre, pa të ngrihej rishtas e të lëkundej në ajër dora topolake e drejtorit. Lëkundej poshtë e lart, majtas e djathtas me ritmin e një zëri që nuk thoshte gjë tjetër veç "andej, andej". Andej, andej dhe dora me gishtërinjtë e hapur përgjysmë bënte rrathë të pakapshëm në ajrin e ngopur me diell, që asaj ia përcëllonte shumë e më shumë lëkurën e fytyrës.

II

Në breg të detit arritën para perëndimit të diellit. Sapo u ngjitën në dhomë, një dhomë tepër e madhe, me dy shtretër të gjerë për një trup njeriu, por të ngushtë për të fjetur dy dhe çuditërisht të ndarë nga njëri-tjetri, - të tillë Sana nuk kishte parë kurrë nëpër hotele, - Gori nxitoi të ulte plotësisht grilat e të dy dritareve të mëdha si dhe grilën e ballkonit. Sana e ndiqte me një vështrim pothuajse nxitës. Nuk ndjente nevojë për fjalë. Në hamendjen e saj ai e donte errësirën për atë që do të ndodhte pa vonesë midis tyre. Domethënë se dhe ai kishte, po ashtu si ajo, padurim. Ajo kishte dëgjuar gjithmonë të flitej për “natën e parë” dhe i tha vetes qetësisht se një gjë e tillë duhej të ndodhte, me sa duket, vetëm në kushtet e natës. Ajo mendoj me një xixëllimë të largët xhelozie se Gori, aq i qartë në ato që po bënte, do të kishte me siguri edhe përvoja me femra të tjera. Pastaj e përzuri pa vështirësi këtë mendim si të parëndësishëm. Ai tashmë ishte me të dhe krejt i saj. Kaq i mjaftonte. Ajo do të kishte dashur, megjithatë, që ai, para se të merrej me mbylljen e grilave,

të gjente një zgjidhje për bashkimin e shtretërve. Sana e mati edhe një herë më sy secilin shtrat dhe tha me vete se të dy ishin njësoj të gjerë. Asnjëri nuk merrte lirisht dy veta. Ose ndoshta edhe kjo hynte te hollësitë e posaçme të “natës së parë”, që Sana nuk e njihte ende. Shtrati nevojitej mbase i ngushtë për t’i mbajtur të dy trupat gjithë kohën shtrënguar pas njëri- tjetrit, në mënyrë që edhe lëvizja më e vogël e njërit apo e tjetrit të jepte fërkim të shalëve, të vitheve apo një shtypje të lehtë të gjinjve. Gori u sigurua se grilat ishin puthitur plotësisht për t’i prerë rrugën edhe rrezes më të hollë diellore dhe kërkoi menjëherë të fiknin dritën.

- Të fikim dritën?! Pse? - u hodh Sana duke hetuar një çast të gjente në shprehjen e fytyrës së tij atë që ajo priste: padurimin e dashurisë. Nuk po e gjente. Sana pa orën. S’kishte vajtur ende gjashtë e pasdites. Ishte shumë herët për të filluar “nata e parë”. Largësia, që kishte vendosur sakaq Gori me të nëpërmjet një ftohtësie, me të cilën ishte mbështjellë siç mbështillet trupi me një peshqir të lagur, ishte doemos një shenjë nga ana e tij për gruan. Sana uroi vetëm që ai të mos kishte në kokë të njëjtën frikë që kishte ajo. Ai nuk duhej të mendonte se trupi i gruas së tij nuk ishte i aftë ta mbante një dashuri që do të zgjaste me orë e me orë siç ishte koha që ata kishin përpara deri të nesërmen në mëngjes. Sana u përpoq të kujtonte nëse nëpër fjalët e saj kishte rrjedhur ndonjë fije e mosbesimit që kishte ajo tashmë në gjallërinë e trupit të vet. Ky ishte një ankth i ri, të cilin ajo nuk e kishte njohur para kthimit të Gorit dhe nga i cili e kuptoi se nuk do e kishte të lehtë të çlirohej. Por ishte e vendosur të çlirohej si nga një pengesë e bezdisshme për lumturinë e saj.

Sidoqoftë, ata kishin përpara një mbrëmje të tërë, e cila nuk do të mund të ishte kurrsesi një mbrëmje e zakonshme. Ishte mbrëmja e parë e kthimit të vonuar të Gorit. Për më tepër, kjo ishte dhe mbrëmja e tyre e parë e përbashkët në vetmi të plotë, në një dhomë të pastër e të qetë hoteli, ani pse shtretërit ishin të vendosur ashtu përçudshëm, thua se në ta do të shtriheshin njerëz të huaj, që nuk duhej ta shihnin të zhveshur njëri-tjetrin. Punë e madhe! Pa e shpërdoruar kohën e dashurisë, ata mund të bënë edhe plot gjëra të tjera të këndshme gjatë asaj mbrëmjeje. E sidomos të flisnin. Kishin aq shumë për t'i treguar njëri-tjetrit! Gorit nuk i lejohej të vazhdonte pafund ashtu i mbyllur në veten e tij dhe pa kureshtje për jetën e Sanës gjatë mungesës së tij. Gjatë udhëtimit me tren nga Tirana për në Durrës, ai pothuajse nuk e kishte çelur gojën. Vetëm shikonte nga dritarja peizazhin bujqësor që dukej sikur digej ngadalë nën rrezatimin e zbardhëllyer të diellit. Ai kishte në fytyrë një habitje të papërshtueshme, të cilën Sana nuk e lidhte aspak me çfarë shihte ai nga dritarja e trenit. Nuk do të kishte kuptim që ai të habitej nga pamje të tilla aq të rëndomta si arat e korrura, ku kashta e grurit, e hedhur dosido, jepte një përshtypje braktisjeje e shkretëtire. Habitja e tij buronte së brendshmi dhe merrte kuptim pikërisht pse nxirrte jashtë, e bënte të dukshme për Sanën, ëndërrimin e tij, që nuk mund të ishte tjetër veç i lidhur me mbrëmjen e jashtëzakonshme, drejt të cilës po shkonin për t'u pasuar nga "nata e parë" edhe më e jashtëzakonshme. Ata kishin zgjedhur Durrësin për të kaluar atë arratisje mjalti vetëm pse ishte qyteti bregdetar më i afërt me Tiranën dhe nuk do të humbisnin kohë rrugëve nëpër trena e autobusa të ngathët e që mbanin erë të keqe. Dhe mbrëmja e tyre e

parë e përbashkët do të ishte lirisht e gjatë, e bollshme për t'i paraprirë natës së parë të dashurisë. Do të ishin pa kursim orët e ëmbla, me qëllim që trupi dhe shpirti i tyre të nxeheshin ngadalë ashtu siç nxehet ngadalë hekuri para se të farkëtohet.

Tani që kishin mbërritur në dhomën e hotelit, kishin kyçur derën nga brenda dhe mbrëmja po binte pa u ngutur mbi gjysmën e botës ku gjendej strofka e tyre, Sana duhej t'i harronte të gjitha paralajmërimet e gëzueshme, që e kishin përhumbur e lumturuar qysh në mëngjes. Gori kishte kërkuar të fiknin dritën dhe asaj i mbetej të kënaqej me mendimin se ai ishte diku pranë, brenda të njëjtave mure me të, por i padukshëm, i përpirë nga errësira asgjësuese. Jo! Klithi ajo së brendshmi. Si mund të ketë gjumë sonte?! Sigurisht që nuk ka gjumë. Drita do të rrijë ndezur. Ajo ishte e vendosur që atë mbrëmje ta kalonin duke folur. Kishte aq shumë nevojë ta dëgjonte Gorin t'i tregonte për jetën e vet larg saj. Por edhe ajo donte t'i tregonte për jetën e vet dhe do t'i tregonte qoftë edhe sikur ai të mos shfaqte asnjë kureshtje. E folura do e çlironte, do e përgatiste për të qenë më e epshme në shtrat kur të fillonte e bekuara “natë e parë”. Ajo nuk do të ishte në gjendje të fliste dhe as të dëgjonte në errësirë. Sana nuk mbante mend nëse ia pohoi Gorit apo jo se sa gjatë dhe me durim e kishte pritur këtë mbrëmje. Dhe u gjend në mëdyshje. Si do të ishte më mirë, ta dinte Gori apo të mos e dinte se me çfarë durimi e kishte pritur? Sana u rrëqeth nga zbulimi i paaftësisë së vet për të qenë e shpenguar me Gorin.

- Jam i këputur nga lodhja, - foli Gori me një zë të zvarritur. - Mezi po mbahem në këmbë.

Ai fliste me kokën të ulur. Sana, që nuk ia ndante sytë, ia dalloi kapitjen dhe zgjati dorën ta përkëdhelte në qafë

me një përkujdesje instinktivisht ngushëlluese. Befas ajo nuk kishte fuqi të mendonte. Nuk kishte parë kurrë fytyrë burri që të fishkej ashtu sakaq, me një shpejtësi të padukshme. Ajo u kujtua për krahun e vet të mbetur pezull. Qafa e Gorit ishte para syve të saj, e veshur me një hije të lehtë, të ndritshme si pluhur argjendi. Megjithatë, bulëzat e gishtërinjve të saj kushedi pse nuk e mbërritën dot. Ajo ndërkohë ndjeu një gjarpër të hollë t'i lëvrinte në gropëzën midis gjinjve dhe kuptoi e lumturuar se Gori kishte përfitur nga pavëmendja e saj për të kapërcyer ndrojtjen e vet. Ose ajo kishte qenë mënyra e tij e rafinuar për ta nxjerrë gruan e vet nga hutimi. Ai e kishte prekur aty ku ajo nuk kishte ndjerë kurrë një dorë burri dhe... Gjarpri i hollë lëvriu përsëri në gropëzën midis dy gjinjve të Sanës, shenjë kjo se në fakt nuk do të kishte gjumë për njërin e as për tjetrin. Në të vërtetë Gori nuk kishte përmendur ndonjë dëshirë gjumi. Po mua nga m'u shpif një marrëzi e tillë? pyeti veten Sana e lehtësuar. Detyrimi për gjumë do të kishte qenë një torturë, që ajo nuk do të kishte qenë në gjendje ta mbante. Ajo u vu e tëra në pritje të lëvizjes së re të gjarpërit të hollë përreth gjinjve të saj të nxehur e të fryrë. Përtej ankesës për lodhjen, - Sana e dinte tashmë, - aty, midis gjinjve të saj ishte vendi ku Gori e shprehte përkushtimin e vet të ëmbël prej burri ndaj saj. Ajo ishte e sigurtë se kafsha e vogël ishte brenda asaj gropëze dhe përgjonte, sado që nuk po ndjehej më.

*

Sana nuk do të mund të flinte. Megjithatë, ishte në detyrën e saj të përpiquej. Një frikë, e ngulitur me kohë në trurin e saj nga vetmia e shtratit, e kishte mësuar t'i bënte

ballë kësaj frike: ajo shtrihej vetëm kur ndjente t'i rëndoheshin padurueshmërisht qepallat. Sana vuri re se vazhdonte të qëndronte në këmbë në një pikë të tillë të dhomës për ta penguar edhe me trupin e vet Gorin, në qoftë se ai do të lëvizte drejt çelësit për të fikur dritën.

- Dalim jashtë! - tha ajo. - Shëtisim pak bregut të detit... Ty të pëlqen perëndimi i diellit dhe gurgullima e ujit të detit te këmbët, apo jo? Edhe mua më pëlqen. Ose ulemi në lulishten para hotelit, si të duash! - Nuk e kuptoi nga i erdhi gjithë ajo druajtje, si të qe duke i kërkuar diçka të turpshme.

Gori nuk u përgjigj. Sana nuk i shihte sytë e tij.

- Do të çlodhesh, - shtoi ajo, pa arritur ta përzinte sadopak druajtjen. Për ta fshehur disi mungesën e besimit në vete, ajo mori drejt derës pa pritur miratimin e tij.

- Ah, jo! Nuk mundem. - Gori ngriti kokën ndërkohë që zgjati dorën ta mbante. Lodhja ishte aty, si një pllakë e vjetër bronzi, e puthitur pas tipareve të fytyrës. - Nuk mundem. - Dhe heshti duke u shtrënguar për të bërë një buzagaz shfajësues. Pastaj uli përsëri kokën dhe vazhdoi: - Ka shkuar shumë vonë dhe ti e di, nata mua... do t'u dukem të tjerëve si i ngritur... - Atij iu shprishën fjalët nëpër dhëmbë dhe Sana nuk arriti të merrte vesh asgjë.

Ajo u mat sidoqoftë ta kundërshtonte. Nuk kishte shkuar vonë. Madje nuk kishte perënduar ende mirë dielli. Errësirën në dhomë e kishte sjellë ai vetë duke ulur deri në fund grilat. Ajo do të guxonte për herë të parë ta qortonte. Mos fol përçart! do t'i thoshte. Kur po orvatej të gjente një fjalë pak më të butë se "përçatje", një dorë e fshehtë fiku dritën. Nuk ishte Gori. (Sana ishte e sigurtë që Gori nuk kishte lëvizur as gishtin.) Llamba e fikur papritur ishte bërë sakaq më e zezë se terri dhe fluturoi drejt e në gojën e

saj, i zuri fytyr. Sana nuk mund të nxirrte më zë. Ajo mbeti e shtangur në këmbë, në mes të dhomës. Si ndodhi? Çfarë ndodhi? Çfarë po ndodhte? Ku ishin? Mungesa e përnjëhershme dhe e plotë e ndriçimit i shtyu me shpejtësi larg muret dhe derën e dhomës. Hapësira e re, thuajse e pakufizuar, i mbolli Sanës nëpër gjithë trupin ndjesinë e njohur të braktisjes, të cilën, qysh nga mëngjesi i asaj dite, ajo kishte besuar se nuk do e provonte më kurrë. Nisi të dridhej. Errësira ishte e ftohtë. Ndryshe nga zakonisht, kjo ndjesi braktisjeje kësaj here ia fshiu krejt kujtesën. Truri mbeti i bardhë e i squllur a thua se zhgualli i kokës ishte mbushur befaz me gëlqere të ngopur me ujë. Ajo nuk mbante më mend pse pati ardhur këtu, në këtë dhomë të panjohur e të pazakonshme, me kë kishte ardhur, kur kishte ardhur. Nuk mbante më mend asgjë. Mprehu veshin një çast me shpresë t'i vinte ndonjë zë, ndonjë zhurmë, ndonjë shenjë e njohur, sa për t'i kthyer kujtesën. Vetëm heshtje. Bota mbarë ishte zhytur në detin e thellë të heshtjes. Kishte vdekur sakaq edhe tiktaku i orës së dorës, që ajo ishte mësuar të dëgjonte në vetminë natore në apartamentin e saj në Tiranë. Sana çoi instinktivisht dorën e djathtë te puls i majtë, a thua se aty duhej të ishte zembereku i orës, që nuk po e dëgjonte.

Duke pritur ashtu, me veshë të mprehur për të kapur një zhurmë çfarëdo nga universi, sytë e Sanës filluan të mësoheshin me terrin. Dikur vonë, në njërin nga krevatet e që nuk ishte krevati i saj, ajo dalloj hijen më të zeze se terri, të një njeriu, i cili rrinte ulur në cep. Nuk ishte shtrirë. Uf! tha ajo me vete qortueshëm. Ç'pata që e humba kështu?! Mos më zuri gjumi në këmbë pa e ndier? Aty ishte Gori. I tëri. Ajo nuk duhej ta pyeste se ku ishte zhdukur ai pak më parë. Kushedi ç'përgjigje do të merrte! Dhe nuk

e pyeti. Sana kishte arsye të mbetej e kënaqur me veten. Ajo po mësonte me shpejtësi të dallonte pyetjet që nuk duheshin bërë. Me rëndësi ishte sidomos se ajo po pajtohej për ta kafshuar gjuhën pa hulumtuar pse pyetje të tilla ishin të rrezikshme. Gori nuk ishte zhdukur për asnjë çast. Ai e ndiqte paprerë me një vështrim të butë, xixëllues.

Sana bëri një hap për t'iu afruar drejt tij. Pastaj të dytin. Unë tani jam gruaja e tij, mendoj, si të donte të sigurohej se i takonte t'i hidhte ato hapa. Do të zhvishem në sytë e tij, do ta ndiej vështrimin e tij mbi lëkurë, do ta ndjek atë vështrim për të shmangur fjalët e sikletshme që shprehin dëshirën, do të... Asaj i ngeci diku mendimi. Shtoi, si e zënë në turp: do të fle me të. Për herë të parë në jetën e vet do të zhvishej lakuriq në prani të një burri, nën vështrimin e tij të butë, xixëllues. U step, sido që ky ishte Gori dhe ajo, me përfytyrim, e kishte futur atë burrë më parë qindra e qindra herë në dhomën e vet nga dera e dritarja, natën e ditën, në verë e në dimër dhe në mendje i kishte shkuar të gjitha dialogët e mundshme, duke besuar se, kur të vinte çasti i vërtetë i vetmisë së tyre të përbashkët, ajo do të kishte fituar tashmë një aftësi të mjaftueshme për ta zotëruar veten e për t'i dhënë çdo fjale e çdo gjesti drithërimën magjepsëse, të parikrijueshme. Ai ndodhej më në fund realisht pranë, ndoshta një pëllëmbë më tutje, jo më shumë. Ajo e kuptoi se tërë ai përfytyrim i gjatë nuk i kishte sjellë asgjë të mirë mbrëmjes aq të dëshiruar. Imazhi i zbukuruar, që pati ndërtuar, nuk arrinte të përputhej me skenën e thjeshtë që do të zhvillohej fill dhe, nga kjo mospërputhje, te Sana lindte një gjendje hutimi, ku ajo e kishte të vështirë të mbahej e zonja e vetes. Prandaj po kërkonte sytë e Gorit, me shpresë se mbështetja te ta do t'ia trembte pak druajtjen e mpirjen dhe do t'ia bënte më të natyrshme lëvizjet e duarve për të

shkopsitur fustanin. Kjo ishte më e pakta që kërkonte prej syve të burrit të vet, i cili qëllimisht për t'iu fshehur syve të gruas mbase, për ta lënë krejt vetëm në një çast të tillë të vështirë siç ishte shkopsitja e fustanit, kishte kërkuar errësirën. Ja, pra, pse kishte kërkuar ai fikjen e dritës! S'është e keqja tek errësira, kundërshtoi veten Sana dhe, e paaftë të përcaktonte se ku pikërisht ishte e keqja, u inatos. Sana e dinte se jo rrallë inati i verbër e shtynte në marrëzira. Ajo u përpoq të çlirohej prej inatit dhe e çoi menjëherë mendjen diku tjetër. Intuuta e femrës e mësonte se edhe me një hollësi krejt të vogël mund ta prishte bukurinë e çastit. Ajo porositi veten fort të ishte tejet e kujdesshme. Asaj nuk i lejohej ta prishte bukurinë e këtij çasti të papërsëritshëm siç është e papërsëritshme “nata e parë” e cila i jepet femrës vetëm një herë në jetë.

Ndërkohë, Gori u ngrit ngadalë, u afrua te dritarja dhe ai vështrim i tij i butë e xixëllues, që do të duhej t'i shpërndahej Sanës nëpër fytyrë si një përkëdheli, humbi mbi qelqin e dritares së zënë plotësisht me grila. Nuk kishte “jashtë” për vështrimin e atij burri, por kjo nuk dukej t'i bënte ndonjë përshtypje. Bukuria e natës së parë..., psherëtiu Sana gati në vajë. Çfarë bukurie?! iu drejtua ajo vetes me qesëndi si një shemre. Vajtja e Gorit te dritarja qorre për të qenë me shpinë drejt Sanës, iu duk si shprehja më e rëndë e mospërfilljes së tij. Ishte i palejueshëm një zhvlerësim i tillë nga ana e Gorit ndaj ngjarjes që do të duhej të ishte më e rëndësishmja jo vetëm në jetën e Sanës si grua, por edhe në jetën e atij vetë si burrë. Ai rri e shikon qelqin e zi si një hutaq, ndërsa ti, ngrirë në këmbë, rri i bën hije nga prapa si një statujë e harruar. Madje, as hije nuk bën. Trupi e humbet hijen në errësirë. Pa hijen e tij, trupi mbetet krejt i vetmuar. Të tillë e ndjente Sana trupin

e vet: krejt të vetmuar. Ky shpërthim i erdhi vrullshëm dhe mezi e mbyti në fyt. Do të kishte ulëritur.

*

Inati, të cilin ajo nuk po e zbonde më dot prej vetes, do t'ia kishte errësuar edhe më keq atë natë të papërsëritshme fund pranvere, sikur Gori të mos kujtohej sakaq të fliste, gjithnjë pa e shkëputur vështrimin nga faqja e lëmuar xhamit:

- U zhveshe?

Pyetja e tij e zuri Sanën në befasi e i dha një të çarë të thellë vetëpërmbajtjes së saj gjithsesi të zorshme.

- Pse? Po më prisje mua të zhvishesha?

Gori nuk u përgjigj. Veç u soll nga ajo me një rrotullim fort të ngadalshëm, sikur lëvizte bashkë me dyshtemenë e dhomës. Sana mendoi se lëvizjet e Gorit ishin ashtu të ngathëta sepse atij i mungonte dëshira për t'u kredhur në trupin e saj. Atëherë më mirë të mos fillojë kjo jetë e përbashkët! tha ajo me vete dhe ndjeu njëherësh t'i dridheshin buza dhe gjunjët. Si guxonte ta çonte nëpër mend një gjë të tillë?

Ndërkohë Gori ishte drejtuar plotësisht nga ajo, i gatitur për të hedhur hapin që i ndante dhe të gjendej sërish pranë saj, i ngjitur pas saj me kofshët, barkun, kraharorin, gojën. Por këmba e tij (Sana nuk do të mbante mend nëse kishte qenë e majta apo e djathta), ajo gjymtyra e pajisur me muskuj elastikë për të mbajtur trupin në hovje, kishte mbetur pezull, a thua se e kishte kapur një ngërç i papritur. Gorit nuk i bindej vetvetja. Sana nuk e kuptoi nga i doli ky shpjegim kaq i ndërlikuar dhe, me një përppjekje për ta thjeshtuar, tha me vete se

kjo që po i ndodhte Gorit, tregonte se trupin e tij nuk e urdhëronte zemra. Në rrethanat e tyre të jashtëzakonshme, siç mund të ishte e jashtëzakonshme vetëm “nata e parë”, nuk mjaftonte vetëm urdhri i trurit për ta shtyrë trupin mashkullor drejt trupit femëror. Binte sidoqoftë qartë në sy te Gori vetëdija e tij e lartë për ta kryer detyrën që i takonte ndaj nuses, pranë të cilës do të shtrihej për herë të parë. Gjithçka tjetër në lëvizjet e tij ishte ngurrim, përtesë. Ose diçka edhe më e pazakonshme, të cilës Sana nuk kishte guxim t’i vinte emër. Kështu, Sana tendosi skajmërisht mendimin e vet fillestar, sipas të cilit ai nuk kishte shumë dëshirë të kridhej në trupin e saj. Ndoshta madje nuk kishte dëshirë fare. Qartazi i mungonte edhe pika më e vogël e trazimit në shpirt. Si mund të mbahet kaq i qetë ky burrë! Dhe unë, budallaqja, sa e kam pritur këtë natë! Ajo u pushtua nga një keqardhje e menjëhershme për virgjërinë e vet. Si burrë shqiptar, Gorit i takonte ta çmonte virgjërinë e gruas së tij si një dhuratë të shenjtë dhe të bënte diçka për t’i shprehur sadopak mirënjohjen. Virgjëria ishte themeli i përkushtimit tërësor të Sanës si femër ndaj tij në të shkuarën, që e kishin kaluar veç e veç e në të ardhmen, që do e kalonin bashkë; ishte pengu që jepte ajo si femër për pazëvendësueshmërinë e tij si burrë në jetën e saj. Sa më shumë e bindte veten për zhgënjimin, aq më shumë shihte se i mblidheshin forcat për të mos u ligështuar para tij. Sanës po i ndodhte një lloj kryengritjeje e heshtur. Buza dhe gjunjët nuk i dridheshin më. Por pati përshtypjen se mbajtëset e gjinjve po i zbrazeshin për t’u mbushur me ajër të ftohtë, rrëqethës dhe instinktivisht çoi duart mbi kraharor.

Më në fund këmba e Gorit e kishte përshkuar harkun e padukshëm ajror dhe tani ai gjendej thujse ngjitur me

të. Thuajse ngjitur. Mungonte edhe një lëvizje e vogël, të cilën Sana nuk e dinte nëse duhej ta kryente ajo vetë apo i takonte përsëri atij si burrë. Sana kishte mbetur në mëdyshje.

Ajo ia ndiente edhe zhurmërimën e frymëmarrjes, ani pse jo avullin e ngrohtë të gojës. E tendosur në vetëmbrojtje, Sana u acarua. Nuk ishte në gjendje për ta mposhtur ngacmimin e ëmbël që i shkaktonte ajo zhurmërima e frymëmarrjes së Gorit, një dihatje e thellë me të gjithë trupin. Ai vetëm merrte frymë, nuk nxirrte. Po të vazhdonte kështu, ajri i dhomës me dritaret dhe grilat e mbyllura do të mbarohej. Sana mendoi vetëtimthi për vdekjen shembullore, që do të kishin të dy. E mendoi pa frikë, jo si një rrezik, por si një fund të bukur.

- Nuk qenke zhveshur ende?! - i foli ai butësisht te veshi, duke ia shumëfishuar rrufeshëm ngacmimin gudulisës, ani pse prapë goja e tij nuk lëshoi asnjë fije nga ai avulli që... Sana vazhdonte t'i mbante duart të mbledhura mbi kraharor, aty ku do të duhej të ishin gjinjtë e saj e që tani ishin dy tullumbace të vogla, të fryra me ajër të ftohtë.

- Pse, mua po më prisje të zhvishesha? - përsëriti Sana. Ajo do të donte që dhoma të kishte pak dritë, që Gori të vinte re edhe nënqeshjen ironike, me të cilën ajo e shoqëroi pyetjen e saj, që nuk ishte pyetje. Ajo nuk kishte pyetje për Gorin.

- Sa e bukur bëhesh kur zemërohesh, mor Zot! - i pëshpëriti ai përsëri te veshi, thua se e kishte parë shprehjen e fytyrës së saj të zemëruar. Sana nuk mendoi se errësira e asgjëson bukurinë ashtu siç asgjëson edhe shëmtimin. I erdhi më për shtat të dyshonte nëse vërtet ajo i dukej veçanërisht e bukur tani. Apo ishte një lëvdatë e zakonshme boshe burri, për gruan me të cilën do të bënte

dashuri pas pak. Me siguri që ishte kjo e dyta. Ajo vazhdonte të kërkonte me këmbëngulje vetëm anën e mbrapshtë në të gjitha fjalët dhe veprimet e Gorit.

*

Sana zbuloi diçka që nuk e kishte përfytyruar dot kurrë në vetminë e vet: përndezen turbulluese të gjakut që shkaktonte nën lëkurën e gruas një gojë burri e afruar te veshi i saj. Madje, edhe kur goja e burrit ishte pa atë avullin aq të përfolur, siç ishte rasti. Ose kështu më ndodh vetëm mua, shtoi ajo me dëshirën që rasti i saj të mbetet gjithsesi i përveçëm.

Ishte e pazonja të mbrohej më tej.

Ndërsa Gori, pa bërë zë tjetër, zuri t'ia shkopsiste fustanin. Por gishtërinjtë e tij sikur mezi lëviznin. Duket që edhe ky e ka për herë të parë, tha ajo me vete më në fund e kënaqur. Dhe u kujtua sërish për virgjërinë e vet. Pse nuk flitej kurrë për virgjërinë e burrave? A s'kishin edhe ata virgjëri? Gori po vonohej në zbërthimin e atij fustani të mallkuar. Asaj i ishte ndezur një zjarr diku në fund të barkut dhe po i ngjitej lart drejt kokës me një shpejtësi marramendëse. O Zot, pse kaq ngadalë! rënkoi ajo gjithë padurim. Më mirë të isha zhveshur vetë. Nuk do të isha torturuar kështu. Nuk do ta kisha torturuar kështu as Gorin, tha ajo duke menduar për herë të fundit me pak turp për zjarrminë që i ngjitej nga fundi i barkut për ta pushtuar të tërën.

Ajo ishte lëshuar me tërë peshën e trupit mbi kraharorin e Gorit dhe, pavetëdijshtë, kishte zbritur duart te rripi i pantallonave të tij. Për çudi, me të prekur gishtërinjtë e saj aty, pantallonat e Gorit jo sikur u zbërthyen, por u

shkërmoqën si të ishin prej brumi të tharë niseshteje dhe ajo ndjeu mes shalëve fërkimin e tij mishëror.

Për veten e vet Sana kishte mbetur e mbërthyer në atë djall-fustan si në një rrjetë merimange. Uf! U shkëput për një grimë rrëmbimthi nga Gori, e vendosur ta shkulte me të shqyer nga trupi pëlhurën e mallkuar. E mira e të mirës do të ishte që një dhunë të tillë ta ushtronte Gori. Brinjët e saj të imta do të shkundeshin nën vrullin e burrit. Por mbeti e shastisur, me duar të ngritura drejt qafës. Ajo ishte e zhveshur lakuriq, krejtësisht e zbuluar përpara burrit, i cili e kishte përfshirë me një vështrim pyetës. Ajo nuk e shihte vështrimin e tij, e ndjente gjithandej prekjen e syve të tij. Dhe nuk kërkonte më shumë.

- Ku... më vajti fustani? - foli ajo me gjysmë zëri, duke parë majtas e djathtas. Fustani i saj nuk dukej gjëkund ashtu siç nuk dukeshin as të brendshmet. Thua se i kishte përpirë nata. Sana nuk do të mund të mbulohej më sido që të rridhnin gjërat. Por ajo nuk kishte ankth. Ishte dorëzuar. Dhe gjëja e fundit që do të dëshironte tashmë, do të kishte qenë të mbulohej.

- Pse? Do të ikësh? - Zëri i Gorit ishte i mekur.

Sana e kuptoi shkakun e pyetjes në vështrimin e Gorit dhe e zuri frika se mos e kishte prekur diku me sjelljen e vet të panatyrshme. Megjithatë misteri mbetej: Si e kishte zhveshur ai ashtu, pa u ndjerë fare? Thua se fustani i saj bashkë me të brendshmet nuk kishin qenë kurrë mbi trupin e saj.

- Jo... ç'ne... ku do të iki?!... Po nuk e marr vesh kur... si jam zhveshur... Vërtet, si?...

- Thashë se mos ndërrove mendje... - ia ktheu Gori si të mos e kishte dëgjuar pyetjen.

Sana do të kishte dashur të pohonte me siguri se zëri i Gorit ishte me një ton krejt hokatar, por nuk ishte në gjendje. Në pyetjen e tij për ndërrimin e mendjes kishte një si dyshim që nuk shkonte.

Nëse Gori do t'i kishte kërkuar ndonjë arsye përse ajo ndjehej e shqetësuar, do të kishte gabuar rëndë, duke e shtyrë Sanën drejt një zinxhiri kundërshtimesh, ku nuk do të ishte çudi që edhe gjuha e saj të ashpërsohej. Nuk jam e shqetësuar, do të hidhej ajo. Ku e sheh ti që jam e shqetësuar? Në rast se Gori do të këmbëngulte që Sana ishte e shqetësuar, Sana do e pranonte. Po, do i thoshte, jam e shqetësuar. Shumë e shqetësuar madje. Dhe do ja zbraste thesin me vërejtje, që i kullonte thartësisë si një ulcerë në fund të stomakut. Gori gjeti një mënyrë krejt tjetër, fare të paparashikueshme, për ta nxjerrë nga sikleti.

- Ti lakuriq ke lindur, ndaj dhe lakuriq je më e bukur... Si mund të jesh ndryshe sonte veç lakuriq?!

Sana besoi se burri e kishte arritur më në fund lidhjen e dëshiruar me trupin e saj prej femre. E përshkoi një rrëqethje kënaqësie dhe nuk u kujtua më të pyeste të paktën veten si e shihte ai lakuriqësinë e saj kur dhoma ishte e tëra e zhytur në terr. Uf! Sa i lodhshëm fillimi! Megjithatë, nga nevoja e kotësisë vajzërore për të mos u dorëzuar lehtësisht, mendoj se nuk ishte e hijshme nga ana e tij shprehja aq e drejtpërdrejtë e vlerësimit për lakuriqësinë e saj të bukur. Dhe, pavetëdijshtë, çoi të dy duart midis shalëve. Kujtoi se gjithë lakuriqësia e saj femërore, që duhej gjasme mbuluar, ishte mbledhur aty. Ndërsa dy pëllëmbët e Gorit i mbështollën me përkëdheli supet dhe e afruan në kraharorin e vet. Ajo vuri veshin te vendi ku duhej të ishte zemra e tij, por nuk dëgjoi asgjë. Kjo nuk duhej të ishte shenjë e mirë. Me ç'dinte ajo, në ato

rrethana zemra rreh si e çmendur. Ja si kërcente e përpëlitej zemra e saj, si një ketër i zënë në çark! Ndoshta kjo ndodh vetëm me zemrën e gruas. Sana nuk dinte si ta qortonte veten pse po shtyhej në vëzhgime që rrezikonin ta prishnin kënaqësinë e panjohur, të cilën po ia jepte shtrëngimi i Gorit, edhe pse ai ende nuk po fillonte ta puthte. Ajo besoi se edhe kjo zvarritje ishte pjesë e torturës mrekulluese të natës së parë...

Gori e ngriti në krahë. Do ta vinte në shtrat. Ajo u kacavar në qafën e tij. Më në fund ai bëri diçka të përngjashme me përfytyrimin e vjetër të Sanës për vajtjen e parë në shtrat me burrin. Fytyra e tij rrinte tashmë varur mbi të sajën. Pothuajse ngjitur. Pra, jo ngjitur. Ajo pati kohë të vinte re mirë diçka që e kishte ndjerë si një mungesë pak më parë, kur goja e tij ishte qasur te gropa e veshit të saj: nga goja e Gorit dilte frymë, por kjo frymë nuk ishte e ngrohtë, siç duhet të jetë fryma e burrit. Nuk ishte as e ftohtë. Sana do të kishte thënë se kjo frymë nuk kishte asnjë lloj temperature. Ajo u kujtua përsëri që pak më parë nuk ia kishte dëgjuar as zemrën t'i rrihte. Megjithatë, Gori sikur nuk e kishte më në lëvizje atë ngathtësinë e fillimit dhe kjo ishte për Sanën një arsye e mjaftueshme për t'u kënaqur. S'ka gjë se ende në gojën e tij mungonte ai avulli turbullues. Ajo nuk arrinte ta çonte asnjë mendim deri në fund. Ajo ndodhej tashmë e shtrirë në kurriz, përmbi çarçafë dhe trupi i tij e kishte mbuluar të tërën. Ajo nuk shihte më asgjë. Dhe aq më mirë! Duart e saj lëvizën edhe një herë pavetëdijshtëm, që të shkonin tek ai vendi në mes të shalëve nga ku vazhdonte t'i ngjitej një nxehtësi e largët dhe e zhurmshme, si zgjimi i një vullkani. Duart e saj nuk shkuan dot asgjëkund. Dhe sidomos jo tek ai vendi ku bashkohen të dy shalët. Barku i Gorit mbi barkun e saj

ishin puthitur pas njëri-tjetrit tashmë. Sana pati nevojë të fliste dhe, pa u menduar çfarë do të thoshte. Belbëzoi:

- Unë jam e virgjër... Kujdes, të lutem! Ngadalë... Do të më dhëmbë...

- Ishe, po nuk je më, - ia ktheu Gori me një zë të mbytur. - Nuk je më e virgjër. As unë nuk jam...

- Si?... Kaq shpejt... Po dhimbjet?... Po gjaku?...

- Dhimbjet dhe gjakun e virgjërisë tënde i kam shlyer unë me...

Zëri i tij erdhi duke u shuar. Ndërsa Sanës, që ende nuk shihte asgjë dhe as nuk donte të shihte, iu prenë fuqitë për të pyetur më tej. Ndjehej aq mirë e fshehur nën trupin e tij. S'ka gjë se Gori fliste përçart. Në fund të fundit e tillë do të ishte doemos humbja e virgjërisë: një dalldi, një përçatje, ikje, qoftë edhe përkohësisht në një botë tjetër për të qenë ndryshe në kthim.

III

Nata zbriti duke i mbytur urtësisht, por pamëshirshëm në mishin e vet të butë të gjitha zhurmat e detit dhe të tokës. Ose ndoshta jashtë, në oborrin e hotelit, në kafene, në restorant, në breg të detit, vazhdonte një jetë e zhurmshe. Por Gori e kishte prerë lidhjen e tyre me atë jetë qysh kur u mbyllën në dhomë dhe ai uli deri në fund qepenat e dritareve dhe të ballkonit. Tashmë as Sana nuk donte më të dinte për atë jetë, e cila u përkiste të tjerëve. I mjaftonte jeta që kishte këtu brenda me Gorin, vetëm me Gorin. Ajo u çudit sidoqoftë pse nuk i kishte rënë në sy më parë që qetësia e plotë e vret gjumin edhe më keq se zhurma e madhe. Ajo zakonisht i kalonte mbrëmjet krejt e vetme në apartamentin e saj në Tiranë. Pavarësisht se grilat nuk i mbyllte kurrë, kur shkonte ajo në shtrat, rrotull mesnatës, jashtë në qytet njësoj si edhe brenda në shtëpi gjithçka kishte rënë në heshtje të shurdhër. Por kësaj here, me Gorin, me sa dukej edhe heshtja e kishte pushtetin krejt ndryshe.

Sana besoi se po i ndodhte diçka e mirë dhe u gëzua. Ajo ishte në gjendje të dallonte se heshtja në apartamentin

e saj në Tiranë ishte ndryshe nga heshtja që sundonte në atë dhomë hoteli pasi kishin bërë dashuri me Gorin dhe ajo i kishte dhuruar burrit të jetës së saj virgjërinë e vet. Duke bërë një dallim të tillë midis këtyre heshtjeve, që nuk ishte i lehtë për këdo e veçanërisht për trurin e saj të tronditur, Sana pati përshtypjen e mirë se po i ringjallej kujtesa. Truri i saj, i pamësuar me një arratisje të tillë nga jeta e jashtme, nisi të punonte më ethshëm për ta mbushur me jetën e vet të brendshme mungesën e ngacmimeve të jashtme. I duhej të krijonte njëherësh banalen me fisniken, absurden me të arsyeshmen, t'ia sillte mendimit figurën e përshtatshme duke e nxjerrë edhe nga hiçi për t'ia plotësuar përmbajtjen e mbrujtur po ashtu me pakogjë - diçka si një hi i një kohe të pajetuar - të thërriste në ndihmë kujtime nga më të largëtat, e sidomos, të thurte parashikime për të ardhmen, ku mundësisht të përputhej sa më mirë dëshira e fshehtë me rrjedhën e vetvetishme të ngjarjeve. Gjithçka kalonte përmes një procesi të pambarim pyetjesh e përgjigjesh, pohimesh e mohimesh, miratimesh e kundërshtimesh të lodhshme. Sana psherëtiu duke mbajtur sakaq frymën nga droja e prishjes së heshtjes.

Shtretërit ishin krahas. I ndante një rruginë e ngushtë dhe komodina e përbashkët te koka. Aty ishte vendosur edhe abazhuri, që mund të përdorej njëkohësisht nga të dy, por që Sana nuk kishte të drejtë ta ndizte. Gori e donte dhomën pa dritë. Tashmë që kishte një farë ringjalljeje të kujtesës, Sana ishte në gjendje të vinte re symbyllur edhe hollësira të tilla si kjo e shtretërve, të cilët nuk ishin në vendin e mëparshëm. Kur u ngjiten në dhomë në fund të pasdites, Sanës i kishte bërë menjëherë përshtypje pse nuk kishin një shtrat të madh siç i nevojitej një çifti, por dy

shtretër tek, për me keq, të vendosur përçudshëm në kënde të pjerrëta ndaj njëri-tjetrit, a thua se në ta do të shtriheshin njerëz të huaj, që nuk duhej ta shihnin të zhveshur njëri-tjetrin. Tani shtretërit ishin krahas, me një rruginë në mes dhe komodinën e përbashkët te koka. Kush i kishte lëvizur shtretërit? Sana për veten e saj ishte e sigurtë që nuk kishte marrë pjesë në këtë punë. Dhoma kishte qenë gjithë kohën e zhytur në errësirë dhe mbetej t'i kishte zhvendosur Gori. Sana e pranonte që, me vështrimin e vet të pamësuar me errësirën e thellë, mund edhe të mos e vinte re dikë të hynte në dhomë siç nuk e kishte vënë re Gorin tek lëvizte me shtratin nga njëra anë e murit në tjetrën. Por ajo do e kishte ndjerë me patjetër aromën e një trupi të huaj dy-tre hapa larg hundës së saj aq të ndjeshme. Doemos që Gori i kishte lëvizur - dhe mirë kishte bërë - për t'i vënë krahas. Ata nuk ishin më dy njerëz, që duhej t'ia fshihnin lakuriqësinë njëri-tjetrit.

Edhe pas një përgëzimi të tillë të sinqertë për Gorin, ajo përsëri nuk arriti ta qetësonte një krimb që po e brente diku në tru e që nuk ishte krimbi i zakonshëm i kureshtjes. Sana ishte plotësisht e bindur se në dhomën e tyre nuk kishte hyrë askush. Lëvizja e një shtrati tek, qoftë edhe në errësirë të thellë, ishte një punë e lehtë për një burrë të fuqishëm si Gori. Por edhe një burrë i fuqishëm si Gori nuk mund ta kryente një punë të tillë pa e gërvishtur sadopak këmbën e shtratit pas pllakave të dyshemesë. Sidomos kur kjo punë do të kryhej në një errësirë të thellë. Gërvishtja ishte nga ato lloj zhurmash që nuk do t'i shpëtonte kurrësi veshit të Sanës. Ajo nuk kishte dëgjuar asgjë prej gjëje. Sana u pushtua nga një dyshim i tmerrshëm: mos ishte shurdhuar? Kjo do të shpjegonte edhe heshtjen shtypëse, ku ishte zhytur. I mjaftoi pak

përqendrim për t'u çliruar nga ky dyshim, të cilin nuk do të mund ta mbante pa u çmendur. Nga shtrati tjetër dëgjohej frymëmarrja e Gorit, një frymëmarrje e largët, por e dallueshme si frymëmarrje, e cila afrohej ngadalë me një jehonë të çrregullt, si të thyer përmes një tuneli të përdredhur. Sana e përzuri sakaq nga përfytyrimi përngjasimin me rënkimin e një njeriu pa mushkëri.

Ajo shau trurin e vet që ishte në gjendje të sajonte një përcudë të tillë të frikshme si ajo e njeriut pa mushkëri dhe u përqendrua me gjithë vështrimin në drejtimin nga vinte jehona e çrregullt e frymëmarrjes, e vendosur ta shponte me sy e me hundë edhe errësirën më të dendur, për të shquar diçkanë e vetme që i kishte munguar vërtet gjatë asaj mbrëmjeje të jashtëzakonshme: ngrohtësinë e frymëmarrjes së burrit që e kishte zhvirgjëruar. Ai do të mbetej për jetë të jetëve krijesa njerëzore më e shtrenjtë për Sanën siç mund të jetë vetëm burri që e kishte bërë grua, duke i plotësuar dëshirën më të thellë të shpirtit të saj. Sana nuk do ta mbante mend kurrë se në cilin çast të mbrëmjes u dorëzua, në cilin çast saktësisht e ndjeu Gorin brenda vetes për herë të parë. Edhe pse nuk i kishte këto hollësi, - dhe nuk do të ishte kurrë në gjendje t'ia shpjegonte vetes pse nuk i kishte këto hollësi që çdo grua i ruante të gdhendura për jetë në kokë, - asaj i jepej kështu mundësia ta kujtonte sikur futja e Gorit brenda saj kishte ndodhur pashtershëm gjatë gjithë mbrëmjes, gjë që do ishte gjithsesi më e pëlqyeshme se saktësia e hollësive. Ajo kishte tashmë “natën e vet të parë”, e cila nuk humbte asgjë pse nuk pjesëtohej në çasti i parë, çasti i dytë e kështu me radhë.

Sana po përpiquej ta largonte vëmendjen nga shtrati i Gorit. Oshtima, që i vinte në veshë, ngjante gjithnjë e më pak me një frymëmarrje burri në gjumë. Ne veshët e saj

mbërrinte një rrokullimë tingujsh shumë e më shumë e ngjashme me një rënkim. Dhe ishte një rënkim i një të panjohuri, me të cilin Sanën nuk do të duhej ta lidhte gjë. Rrjedhimisht, edhe përgjimi i saj për të pikasur sa i ngrohtë ishte ajri i dalë nga mushkëritë e të panjohurit gjatë nxjerrjes së rënkimit, ishte një ushtrim më së paku krejt pa kuptim. Megjithatë, rrokullima e tingujve zinte vend në veshët e saj si një luzmë insektesh helmues për gjykimin e saj.

Në të vërtetë, duke u vënë emra të huaj zhurmave të paqarta, Sana po përpiquej ta nxirrte jashtë vetes shkakun e pagjumësisë e kështu edhe të përngjasehej në sjellje me Gorin për sa i përkiste ruajtjes së kontrollit mbi emocionet e forta, siç ishin doemos të forta emocionet e asaj, që për ta ishte “nata e parë”. Thellë-thellë Sana e njihte fare mirë arsyen e pagjumësisë së vet dhe e pushpjegueshme i dukej tamam e kundërta, domethënë që Gori flinte. Dhe flinte aq i qetë! Lum si ai për vullnetin e vet! mërmëriti ajo pa asnjë shenjë admirimi. E kundërta do e kishte bërë ta admironte burrin e vet. Sana nuk mund ta kuptonte ndryshe këtë natë, veçse duke e zbardhur bashkë të dy. Madje, një hop ajo pati shpresë se ashtu do të ndodhte. Gori, i rrëmbyer nga dalldia e dashurisë, nuk e shfaqte më gjëkund lodhjen e fillimit dhe ajo po gëzohej. Kur ai tha se kishte shkuar shumë vonë e se duhej marrë një sy gjumë, asaj iu mek menjëherë gëzimi. Për më tepër që nuk kishte shkuar shumë vonë. Sana ishte e sigurtë edhe pa parë orën. Por u përpoq të mos e jepte veten. Përderisa atij i flihej, le të flinte! S’mund ta mbante me zor. Dhe nuk kishte as kuptim të përpiquej për ta mbajtur me zor. Ajo do të kishte dashur të dinte vetëm nëse Gori e kishte përjetuar si diçka të jashtëzakonshme çastin kur ishte ndjerë për herë

të parë brenda trupit të saj. Ishte një pyetje që nuk bëhej përderisa as ajo vetë nuk kishte në kujtesë asnjë gjurmë, veç fjalëve të tij që e lajmëronin se nuk ishte më e virgjër. Ajo nuk mendonte se kishte humbur ndonjë gjë të rëndësishme me virgjërinë, por i vinte keq pse nuk e shquante dot qartë nëse kishte fituar atë çfarë priste tani që virgjërinë nuk e kishte më.

Sana i tha vetes se po e tepronte me arsyetime. Kjo nate sidomos nuk mund të ishte nata e logjikës së ftohtë. Por nuk u përmbajt megjithatë pa i kaluar edhe një herë nëpër kokë, qoftë edhe ashtu rrëmujshëm, të gjitha vramendjet e veta qysh nga mëngjesi. E prirur tashmë të përjashtonte logjikën e ftohtë nga kjo ndërmarrje, Sana u ndje më mirë. Në përfundim ajo nuk gjeti shumë lëndë për të prishur gjakun ashtu siç i ishte prishur gjaku gjatë gjithë ditës. Lëri marrëzitë! i tha vetes. Kjo natë, edhe më tepër se gjithë të tjerat e jetës tënde, ka nevojë të jetë natë, të ketë domosdoshmërisht ëndrrën e saj, madje më të bukurën nga ëndrrat që ke parë ndonjëherë. Ëndrra e këtij gjumi do të jetë vazhdim i jetës gjatë mbrëmjes dashurore, do të jetë një ëndërr për të ngrohur deri në lindjen e diellit atë plagën e hollë si petal trëndafili mbetur midis shalëve pas zhvirgjërimit. Si mund të përfytyrohet kjo natë pa një ëndërr që të mbahet mend vite e vite më pas, të tregohet gjithnjë e më me mall dhe pas çdo ngjarjeje të bukur, të gjendet patjetër një paralajmërim pikërisht tek ajo ëndërr?! Si do të na duket ajo ëndërr kur t'ia tregojmë njëri-tjetrit mbrëmjeve pranë zjarrit, duke rrufitur ngadalë një kamomil pa sheqer në pleqërinë e vonë?!

Te kjo pyetje Sanës i ngeci përsëri mendimi dhe Gori, po të hapte papritur sytë, do të shihte buzët e saj gjysmë të çelura, prej nga ngitej deri lart mbi mollëzat e faqeve një

shprehje e pavullnetshme qesëndie dhe ankimi. Si shumë larg e çove pleqërinë, moj qyqare! po i thoshte gjithnjë pavullnetshëm ajo vetes atë çast. Ti që tani je në prag të pleqërisë. Çfarë, çfarë? Qenkam në prag të pleqërisë?! iu hodh një zë tjetër, i cili i përcolli një dridhmë të shkurtër nëpër buzë. Unë qenkam në prag të pleqërisë?! përsëriti ajo, por iu bë se po i shfaqej fytyra e vet, që ishte aq e lodhur, sa nuk arrinte as ta nderte deri në skajet e syve lëndimin e natyrshëm për një grua kur i përmendet pleqëria. Unë sonte kam natën e parë të nusërisë, sonte jam zhveshur për herë të parë para një burri dhe jam dorëzuar symbyllur në krahët e tij, sepse ai është burri im, i pari që ma ka drithëruar zemrën e gjithnjë i vetmi, vazhdoi ajo me vendosmërinë më të madhe ta përzinte edhe nga rrudha e mbrame e trurit atë mendim. Dhe besoi se ia arriti. Megjithatë, i mbeti një shije e hidhur, që i rridhte si lëng i trashë në gojë. Për ta larguar atë shije, u përpoq të ngjallte përfytyrime të shkuara për ditën e martesës së vet dhe t'i krahasonte me rrjedhën që mori bashkimi i saj me Gorin. Nuk guxoi ta quante dasmë. Por nuk do të kishte më as dëshirë ta quante dasmë. Dhe në fund të fundit nuk ishte vërtet dasmë. Le të mos ishte dasmë! Ishte nata e saj e parë në shtratin e një burri, e për më të mirën e të mirave, ky ishte Gori, burri i saj. Mjaftonte.

*

Ndryshe nga bashkëkohësit e saj, Sana u shmangej me sa mundej festave kolektive. Përpiqej të gjente pretekste bindëse për të fshehur nga sytë e shokëve mungesën e dëshirës për të qenë me ta në ditë të tilla. Ata nuk do e